



BASHKIA  
TIRANË

**Drejtuar: Operatorit ekonomik “Kupa” shpk**

**Adresa: KAMEZ Rruga Berisha, Argjinatora me nr.pasurie 482, Çerkeze,Tiranë.**

### FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**Procedura e prokurimit: “Kërkesë për propozim” “Ndërtimi i trotuarëve dhe rehabilitimi i rrugës pranë Njesisë Administrative Petrelë”(Persqopit)”.**

**Përshkrim i shkurtër i kontratës:** Qëllimi i kontratës është: “Ndërtimi i trotuarëve dhe rehabilitimi i rrugës pranë Njesisë Administrative Petrelë”(Persqopit)”.

**Fondi limit: 9,985,642** (nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dyzetë e dy) lekë pa TVSH.

**Burimi i financimit:** vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës në mbështetje të VKB Nr. 84 datë 29.12.2016 për “Miratimin e Programit Buxhetor afatmesëm 2017-2019 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017”.

**Kohëzgjatja e kontratës:** 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

**Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 10.07.2017, ora 10:00.**

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 26 datë 03.07.2017.

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:** çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

**1. Operatori ekonomik “Shamo Konstruksion” shpk**

**NUIS L01326020F**

Vlera e ofertës = **7,320,578** (shttaë milion e treqind e njëzetë mijë e pesëqind e shttaëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

**2. Operatori ekonomik “Sark” shpk**

NUIS K52531415H

Vlera e ofertës = **7,580,566.74** (shtatë milion e pesëqind e tetëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

**3. Operatori ekonomik “Elira” shpk**

NUIS J63423410S

Vlera e ofertës = **7,650,900** (shttaë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH.

**4. Operatori ekonomik “Shansi Invest” shpk**

NUIS J61924002T

Vlera e ofertës = **7,988,508.81** (shttaë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e tetë pikë tetëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

**5. Operatori ekonomik “Kupa” shpk**

NUIS K51615512C

Vlera e ofertës = **8,588,340.85** (tetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e dyzetë pikë tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

**6. Operatori ekonomik “Liqeni VII” shpk**

NUIS K01730502W

Vlera e ofertës = **8,970,927.96** (tetë milion e nëntëqind e shttaëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzetë e shtatë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.

**7. Operatori ekonomik “Bahas” shpk**

NUIS J61827083D

Vlera e ofertës = **9,216,658** (nëntë milion e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

**Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:**

**Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:**

**1. Operatori ekonomik “Shamo Konstruksion” shpk**

NUIS L01326020F

- Operatori ekonomik “Shamo Construction” shpk nuk plotëson pikën 13 të Kapacitetit teknik; *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)/ Autobetonierë”*, pasi një Autobetoniere e ka deklaruar dhe parqitur vetëm me fature dhe Autobetoniere me targe TR8638T nga verifikimi I dokumentacionit rezulton kamion i certifikuar për transport mallrash brenda vendit.

- Operatori ekonomik “Shamo Construction” shpk nuk plotëson pikën 13 të Kapacitetit teknik; *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)/ Autobot uji”*, pasi Autoboti me targë AB802 nga verifikimi I dokumentacionit të paraqitur lloji I mjetit rezulton të jetë gjysëm rimorkio e certifikuar për transport mallrash të rrezikshme.

## 2. Operatori ekonomik “Sark” shpk

NUIS K52531415H

- Operatori ekonomik “Sark” shpk nuk plotëson pikën 1 të Kapacitetit teknik; *“Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 4,992,821 (katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzetë e një) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit..... ”*, pasi për kontratën me objekt: *““Mirembatje rutine performance aksi rrugor Vlore- Selenice”*, mungon Akt koaludimi dhe kontrata është paraqitur e paplotë.
- Operatori ekonomik “Sark” shpk nuk plotëson pikën 6 të Kapacitetit teknik; *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë personelin teknik të domosdoshëm për kryerjen e punimeve 4 (katër) punonjës për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe dëshmi e aftësisë profesionale lëshuar nga institucioni përkatës/ 1 (një) manovrator”*, pasi manovratori nuk figuron në listëpagesat e shoqërisë.
- Operatori ekonomik “Sark” shpk nuk plotëson pikën 6 të Kapacitetit teknik; *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar dhe të rezultojnë në listëpagesat e shoqërisë personelin teknik të domosdoshëm për kryerjen e punimeve 4 (katër) punonjës për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe dëshmi e aftësisë profesionale lëshuar nga institucioni përkatës/ 2 (dy) plakashtrues”*, pasi njëri nga pllakashtruesit nuk figuron në listëpagesat e shoqërisë.
- Operatori ekonomik “Sark” shpk nuk plotëson pikën 13 të Kapacitetit teknik; *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)/ Eskavator me goma”*, pasi për eskavatorin e deklaruar ka paraqitur vetëm faturë doganore dhe jo dokumentacionin e kërkuar sipas pikës 13.a).
- Operatori ekonomik “Sark” shpk nuk plotëson pikën 13 të Kapacitetit teknik; *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)/ Autobetoniere”*, pasi për Autobetonierien me targë KO4380 të deklaruar ne shtojcën Nr.9 nuk ka paraqitur kontratë qera-marrje si edhe foto cka bie në kundërshtim me pikën 13. e).
- Operatori ekonomik “Sark” shpk nuk plotëson pikën 13.e) të Kapacitetit teknik; *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit”*, pasi për kamionat respektivisht me targë AA650LZ dhe AA460 DN nuk ka paraqitur foto.

- Operatori ekonomik “Sark” shpk nuk plotëson pikën 13 të Kapacitetit teknik; *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)”*, pasi për kamionin me targë AA460 DN të deklaruar ne shtojcen Nr.9 nuk ka paraqitur kontratë qera-marrje.
- Operatori ekonomik “Sark” shpk nuk plotëson pikën 13.e) të Kapacitetit teknik; *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit”*, pasi për Autobotin e Ujit nuk ka paraqitur foto.

### 3. Operatori ekonomik “Elira” shpk

NUIS J63423410S

- Operatori ekonomik “Elira” shpk nuk plotëson pikën 13 të Kapacitetit teknik; *“Kandidati ofertues duhet të përcaktoje me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm.....”*, pasi nuk ka paraqitur Deklaratë për Drejtuesin Teknik.
- Operatori ekonomik “Elira” shpk nuk plotëson pikën d të kriterëve të Vecanta; *“Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9”*, pasi nuk ka deklaruar vendndodhjen e mjeteve cka bie në kundërshtim edhe me pikën 13.f).
- Operatori ekonomik “Elira” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit teknik; *“Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)”*, pasi në Shtojcën 9 nuk ka deklaruar rrul me vibrim.
- Operatori ekonomik “Elira” shpk nuk plotëson pikën 13.e) të Kapacitetit teknik; *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit”*, pasi për mjetet; eskavator me zinxhir, autobetoniere me targë TR 3707 L , autobetoniere me targë TR 0413 L nuk ka paraqitur foto.
- Operatori ekonomik “Elira” shpk nuk plotëson pikën 13.a) të Kapacitetit teknik; *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit;b)leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes”*, pasi për kamionet me targë FR4617D dhe AA249DE nuk ka paraqitur çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit si dhe nuk ka paraqitur foto për secilin prej tyre cka bie në kundërshtim me pikën 13.e).
- Operatori ekonomik “Elira” shpk nuk plotëson pikën 4) të Kapacitetit teknik; *“Një punësim mesatar i të paktën 30 (tridhjetë) personave, për periudhën Maj 2016 - Maj 2017 të vërtetuar me; a.Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën Maj 2016 - Maj*

2017;b.List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Maj 2016 - Maj 2017 shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetësore”, pasi nuk ka paraqitur List-Pagesën për muajin Mars 2017.

- Operatori ekonomik “Elira” shpk nuk plotëson pikën 1 të Kapacitetit teknik; “Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën: Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: 4,992,821 (katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e tetëqind e njëzetë e një) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë tri viteve të fundit.....”, pasi për kontratën me objekt: “Rikonstruksioni i rrugës Gjon Buzuku”, nuk ka paraqitur Çertifikatën e Marrjes në Dorëzim.

#### 4. Operatori ekonomik “Shansi Invest” shpk

NUIS J61924002T

- Operatori ekonomik “Shansi Invest” shpk nuk plotëson pikën 1.c) të kriterëve të Vecanta të Kualifikimit: “Përshkrimin e ofertës sipas Shtojcës 1.” Pasi Formulari i Ofertës nuk është paraqitur sipas Formatit të Dokumentave Standarte të tenderit.
- Operatori ekonomik “Shansi Invest” shpk nuk plotëson pikën 13 të Kapacitetit teknik; “Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: kontratë pune të vlefshme, urdhër mjeku, CV, librezë pune, diplomën përkatëse si dhe të të figurojnë në listëpagesa për periudhën e kërkuar...”, pasi mjeku nuk figuron në listëpagesa.
- Operatori ekonomik “Shansi Invest” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit teknik; “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)”, pasi në Shtojcën 9 nuk ka deklaruar matrapik.
- Operatori ekonomik “Shansi Invest” shpk nuk plotëson pikën 3 të Kapacitetit teknik; “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 9)”, pasi për autobetonieren dhe eskavatorin me zinxhir ka paraqitur vetëm faturë zhdoganimi cka bie në kundërshtim edhe me pikën 13.a).
- Operatori ekonomik “Shansi Invest” shpk nuk plotëson pikën d të kriterëve të Vecanta; “Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9”, pasi nuk ka deklaruar vendndodhjen e mjeteve cka bie në kundërshtim edhe me pikën 13.f).
- Operatori ekonomik “Shansi Invest” shpk nuk plotëson kushtin e përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit sipas të cilit: “**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim**”, pasi për Inxhinierin e Mjedisit ka paraqitur fotokopje të Diplomës, të pa noterizuar.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Kupa” shpk**, me adresë: **KAMEZ Rruga Berisha, Argjina me nr.pasurie 482, Çerkeze, Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **8,588,340.85** (tetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e treqind e dyzetë pikë tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Shëtitörja “Dëshmorët e Kombit”, Nr. 1, 1001, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej: **8,970,927.96** (tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzetë e shtatë pikë nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

**Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 19.07.2017.**

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.

